



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 28.09.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtines, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vodosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.09.2018 të parashtuar nga Operatori Ekonomik "RSM Company" për aktivitetin: "Rrethrrrotullimi Lakerishtë-Rrethrrrotullimi Arbëri" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-3326-512 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "**RSM Company**" e datës 27.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Rrethrrrotullimi Lakerishtë-Rrethrrrotullimi Arbëri ",me nr.616 18 3326 512 dhe nr. Brendshëm 616 18 010 512 kundër *Njoftimit për dhënje të kontratës* të AK –së, të datës 24.09.2018, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. Vërtetohet *Njoftimi për dhënje të kontratës* i publikuar me datë: 24.09.2018;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**RSM Company**" me datë 24.09.2018 ka parashtuar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrethrrrotullimi Lakerishtë-Rrethrrrotullimi Arbëri " me Nr.616 18 3326 512 Nr. Brendshëm 616 18 010 512 ". Autoriteti Kontraktues, me datë 28.09.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Pretendimet për shkeljen e qëllimit të LPP-ik(nenit 1) janë të pa qëndrueshme,pasiqë dispozita ligjore nuk përcakton se çmimi më i lirë paraqet mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike,përkundrazi çdo dispozitë ligjore ndërlidhet me faktin se përfitues i shfrytëzimit të fondeve publike duhet të jetë tenderuesi i përgjegjshëm e jo tenderuesit tenderët e të cilëve janë të pa përgjegjshëm,respektivisht tenderët që për ndonjë arsyet e ligjshme janë refuzuar,siqë është rasti me tenderin tuaj;
- 2.Pretendimi tjetër për shkelje të parimit të ekonomizimit dhe efikasitetit,poashtu është i pa bazuar,pasiqë për tenderin e propozuar për dhënje të kontratës nuk është parim vetëm

ekonomiciteti, por edhe efikasiteti që nuk mund të sigurohet me çmimet tuaja dhe sqarimet deklarative;

3. Pretendimet lidhur me nenin 7 poashtu janë plotësish të pa qëndrueshme, pasiqë kërkesat për sqarime janë paraqitur nga AK-ja në bazë të Rregullave pët tenderët jonormalisht të ulët dhe në bazë të të njejtave edhe janë trajtuar dhe atë për të gjithë tenderuesit pjesëmarrës;

4. Pretendimi tjetër se tenderi i juaj ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit është poashtu i pa qëndrueshëm, pasiqë sipas dispoziatave ligjore dhe Rregullave për tenderët jonormalisht të ulët është e drejtë e AK-së që të kërkoj sqarimet lidhur me këto çmime dhe nëse e konsideron se sqarimet nuk janë të mjaftueshme të refuzoj tenderin, si që ka vepruar edhe në rastin tuaj. Çështja që ju e përmendni lidhur me komisionin dhe zyratrin përgjegjës, dua vetëm t'iu sqaroj se është e drejtë ligjore e zyrtarit përgjegjës të pranoj apo refuzoj rekomandimin e komisionit dhe në rast të refuzimit i njejti ose formon komision të ri ose merr Vendim vetë, si që është vepruar në këtë rast;

5. Pretendimi se ju keni dhënë sqarime të mjaftueshme është plotësish i pa qëndrueshëm përvetë faktin se ju keni paraqitur deklarime të pa argumentuara dhe po përseris prap marrëveshje fiktive me disa OE-ik tjerë, respektivisht ju nuk keni detajizuar asnjë çmim nga çmimet që është kërkuar sqarimi, por keni dhënë deklarata pa asnjë detaj dhe marrëveshje me disa OE-ik tjerë vetëm sa për të marr pjesë në këtë aktivitet, pa e dëshmuar në asnjë rast se në afarizimin tuaj jeni furnizuara me materialet e tillë sipas çmimeve më të ulta apo sipas çmimeve të dhëna në tenderin tuaj.

Prandaj veprimet tonë janë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore, pasiqë deklarimet tuaja nuk janë dëshmi e asnjë pozite tuaj të favorshme në treg, përkundrazi tregojnë qartë se sipas çmimeve të dhëna nuk jeni në gjendje të paraqitni elemente përbëre të çmimeve dhe atë përnjë arsyë të vetme: nuk ka parametra teknik dhe financiar që e lejojnë një paraqitje të tillë. Lidhur me sqarimet se ju keni realizuar kontrata me çmime edhe më të ulta me Komunën e Prishtinës ju informoj se të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me këtë aktivitet nuk mund të ndërlidhen me aktivitetet e para tri viteve, sepse po të ishte ajo mundësi do të duhej të përmendnim edhe rastet kur ju në vazhdimësi keni paraqitur ankesa kundër tenderuesëve tjerë me pretendimin se kanë ofruar çmime jonormalisht të ulta dhe atë në aktivitetet me vlera të parashikuara 300,000.00 euro dhe me diferençë në çmime mbi 100,000.00 euro, që paraqet dallim dukshëm më të lartë krahasuar me dallimin që e përmendni ju në këtë aktivitet.

Bazuar në sqarimet e cekuar më lartë është vendosur si në dispozitiv të Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit